

DEKRET
Nr.1807, datë 30.5.1997

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8182, DATË 22.12.1996 "PËR NJË NDRYSHIM NË
LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 "PËR TARIFAT DOGANORE"**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

DEKRETOJ:

Neni 1

Pas shkronjës "d" të pikës 2 të nenit 1 të ligjit nr.8182, datë 23.12.1996 "Për një ndryshim në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"Për materialet dhe pajisjet e importuara nga komunitetet fetare për ngritjen e objekteve të kultit, qendrave sociale, sanitare e kulturore, të cilat do të ndërtohen nga komunitetet fetare, dhe në to nuk do të ushtrohet veprimtari fitimprurëse".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij gjer më 31.12.1997.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha